



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## PROCESVERBALI I MBAJTJES SË MBLEDHJES SË KATERTË TË KKSb-së PËR VITIN 2018

### REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
3. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2018 - 2019.
4. Organizimi i fushatave vetëdisuse për mes aktivitetëve rekreative, kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetarë, KLSP-të dhe bashkësitë fetare.
5. Të ndryshme.

**Selim Pacolli** nënkryetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

**Pika e parë** e Procesverbalit i mbledhjes së kaluar të ditës u miratua nga të pranishmit të KKSb-s me dy vërejtje teknike të cilat do të përmirësohen dhe do të ju përcillet anëtareve.

**Pika e dytë e rendit të ditës**, Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës nga P.K. në këtë pikë të rendit të ditës raportuan tre Komandantët e Stacioneve të Policisë.

**Shkelzen Gjafa** - komandant i stacionit policor qendra i cili tha: sa i përket zonës së sigurisë e vlerësojmë të qetë, dhe se kemi rënie të dukshme 6% ulje të narkotikëve, 61% raste të zëna lende, prishje e rendit dhe qetësisë publike 27%. Shqetësuese për ne janë vjedhjet e rënda ku policia është duke punuar intenzivisht të cilët janë me rroba civile, mbrëmë kemi pas një aksion që nga mesnata ku të shkolla Naim Frasheri kërkesë për mbyllje të lokalit, pastaj të Elena Gjika kemi punuar dhe kemi nxënë kontrabandistët dhe shkelësit e rendit i kemi raportuar. Gjithashtu tha se mos të kemi takime formale dhe kërkoj ndihmën e Inspektionit pasi që ata po punojnë deri në orën 22.00 dhe se ne po kemi probleme me të mëdha pas kësaj kohe dhe në orët e vona kemi aksione kërkojë ndihmën e organeve komunale për të iniciuar dhe lajmëruar rastet e veprave në këtë lëmi që pastaj policia të veprojë me mekanizma të vet.

**Gani Berisha**- Komandant i stacionit policor të jugut tha gjendja e sigurisë është e qetë, kemi disa bezdisje të vogla, kemi punuar me plan operativ kundër vjedhjeve të rënda. Problem i zhurmave të kafiterive. Kemi nevojë për përkrahje ligjore po shkruajmë gjoba, pastaj në gjykatë hedhen poshtë. Inspektioni punon deri në ora 22.00 të mbrëmjes, ndërsa ne kemi probleme me orarin e lokaleve pas kësaj, pastaj ato punët administrative se a ka licence pune dhe çfarë orari është caktuar me vendime nga Komuna. Kane filluar protestat. Është bërë ndërrimi i anëtareve të ri të KLSP. Ka filluar viti i ri shkollor pa asnjë eksces, policia me rroba civile janë duke punuar shumë në siguri dhe nxënien e kryesve të veprave eventuale.



**Isak Ejupi - Komandanti i stacionit policor të veriut** tani jam zgjedhur ,por në këtë detyrë kam qene gjatë edhe më parë. gjendjen e sigurisë për këtë rajon e vlerësojë të qetë dhe stabile edhe pse është multietnike duke marre parasysh edhe masat preventive qe janë ndërmarrë nga policia dhe takimet e shumta me qytetare kemi nxjerr 3 (tri) plane operative në uljen e veprave penale në terren. Ku polica me rroba civile ka arrite të ndalojë shumë vepra të ndryshme penale . I kemi pasur 4 policë të lënduar gjate një aksioni për krim vjedhje të renda Nuk do te ndalemi së kërkuari bashkëpunim me OJQ, shoqërinë civile dhe me organet e drejtësisë .Secili nga këndi i vet të jetë aktiv, ne jemi të hapur për bashkëpunim në fushën e sigurisë.

**Selim Pacolli nënkryetar i Komunës** i uron punë të mbarë komandantit të sapo zgjedhur. Dhe e njoftoj se paraardhësi i juaj Safet Jashari e pate paraqit një kërkesë për caktimi te lokacionit për ndërtimin e qendrës se re te stacionit policor e cila kërkesë tashmë është kryer .

**Idriz Hoxha përfaqësues i fesë islame** -nuk kam diçka te veçante, por nëse ka diçka kyçem më vonë gjate diskutimeve i njoftoj te pranishmit se nga 01.10.2018 gjerë me 30 tetor kemi fushatën për zgjedhjen e myftiut të Kosovës.

**Shkelzen Gjafa komandant i policisë qendra** shfrytëzoi rastin që në këtë forum të paraqes rastin ku në një vendbanim po lexohet kurani ,nuk ka licencë as nga bashkësia islame dhe as nga komuna dhe kërkoj bashkëpunim për të zbuluar këto raste.

**Don Fatmir Koliqi** tha se jemi të kënaqur me punën e policisë dhe se për çdo problem na kanë dalë në ndihmë dhe kanë zgjidhur problemet të ndryshme, situata është e qetë dhe nuk kam diçka konkrete për të raportuar kështu që në ndërkohë nëse ka diçka kyçem.

**Sasha Mitrovic Përfaqësues i kishës serbe** ai tha se gjendja e sigurisë është e qetë dhe se nuk ekese .

**Lulzim Shehu** përfaqësues i fesë se tarikateve tha se problemet duhet parandaluar para se te ndodhin dhe se përcaktimi i pikave kadastrale , dhe se ekzistojnë kompanitë e geometrave dokumentacioni dhe se dalin shumë probleme nëse iniciohet ndonjë ndërtim i ndonjë rruge ose diçka tjetër lindi probleme me pronësi .

**Selim Pacolli** tha se ka probleme të kësaj natyre por këto çështje duhet iniciuar në Drejtorinë e Kadastrat për të zgjedhur problemet në vendin e duhur.

**Pika e tretë -Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor.**

**Jonuz Salihaj Drejtor i Drejtorisë së Arsimit** tha se viti i ri shkollor 2018-19 ka filluar për 75 institucione shkollore të niveleve të ndryshme ku përfshihen 45 mijë fëmijë me 3200 punonjës "Elena Gjika" dhe shkolla "Pavarësia " ku ne nuk jemi fajtor sepse ka pas investime nga TIKA dhe kane pas investime ne shume shkolla 10 ditë para fillimi te vitit ka filluar fasadimi i shkollës .Sa i përket shkollës Pavarësia vonë i kemi siguruar mjetet për 4 paralele të shtuara. Ditët e humbura të mësimi do të kompensohen në funde të vitit shkollor. Për ndryshe jam ithtar i respektimit të drejtave të minoriteteve siç është rasti në Shkollën "Elena Gjika "ku një lende në paralelen turke e jep nj shqiptare , unë kam kërkuar te respektohet vullneti i komunitetit që atë lende ta jap një mësimdhënës i komunitetit turk që të mos këtë diskriminim ndaj ndonjë komuniteti . Gjithashtu ka pas edhe një rast kur komunitet boshnjak i ka mësuar një shqiptare dhe kërkesa e tyre është e arsyeshme dhe nga këndi im do ta përkrah dhe do të iniciojë edhe më larte respektimin e gjuhës amtare të cilit do komunitet dhe edhe ne nivel të Ministrisë së Arsimit do te jap kontributin tim në këtë çështje. Sa i përket problemit të sigurisë neper shkolla ballafaqohemi me dukuri të ndryshme negative siç janë shkolla "Sami Frashri ", "Asim Vokshi" dhe te tjerat , policia me rroba civile është duke bërë



një punë të mire, gjithashtu edhe OJQ- të e ndryshme shoqëria civile prindërit personeli i shkollës sepse mosha prej 13 -14 vjeçare janë përdorues i drogës dhe ne duhet të punojmë intensiv për luftimin e kësaj dukurie të rrezikshme për të rinjtë tanë, shumica e shkollave janë të pajisura me kamera ku së bashku me policin dhe personelin e shkollës mund të kontrollohen kur kemi dyshime për përdorues të drogave . Me kanë ardhur në zyre nëna me fëmijë lidhur me problemin e përdorimit të drogës , pra kemi të bëjmë me një dukuri shqetësuese në shkollat tona dhe na duhet përkrahja e gjithë mekanizmave të tjerë si organet e rendit këshilli i prindërve personeli arsimor për krijimin e një rendi dhe disipline në shkolla.

Ai paraqiti edhe problemin e regjistrimit të nxënësve ku në disa shkolla po ka fluks shumë të madh siç është shkolla "Sami Frashri " dhe kërkoj edhe përkrahjen e prindërve në orientimin e fëmijëve të tyre në regjistrimin e shkollave profesionale siç është shkolla "Gjin Gazulli" dhe se në atë shkollë priten investime të mëdha nga institucionet ndërkombëtare mbi 1 milion euro te cilat drejtme i nevojiten tregut të punës si shembull përmendi 32 vende pune në përpunimin e drurit ku kane aplikuar vetëm 7 kandidat, pastaj përmendi edhe zanatin për saldues ku po kërkohen 700 veta, kërkojë krijimin e një fryme të re në zgjedhjen e profesionit. Të mos ketë ndikim prindërit në zgjidhjen e profesionit të fëmijëve te tyre dhe te orientohen në kërkesat e tregut të punës .

**Ilmi Uka KLSP**-rajoni i Gollakut tha z. Drejtor a ka mundësi që ta fillojmë një iniciativë të re sa i përket zgjidhjes se profesionit të fillojmë rekrutimin e nxënësve dhe prej aty në bashkëpunim me arsimtarët në bazë të afiniteteve të tyre me i orientua në shkolla përkatëse.

**Jonuz Salihaj** orientimi i fëmijëve për klasën e 9(nëntë) në njëfarë mënyre më shumë po reflektohet vullneti i prindërve në zgjedhjen e drejtimit në shkollë si p.sh."Gjin Gazulli"ku ka zgjidhje shumë të mira në drejtimet përkatëse dhe punësim të tyre pas shkollës së mesme , në Komunën e Prishtinës ekzistojnë 8(tetë) shkolla profesionale , ta kemi një memorandum mirëkuptim me prindërit dhe i ftojme që në përputhje me aftësitë e tyre të behet zgjedhja e profesionit dhe plotësimin e nevojave të tregut të punës .

**Ilmi Uka-KLSP** rajoni i Gollakut përsëriti kërkesë për një linje të autobusit në fshatrat e kësaj ane pasi që nuk ka transport të udhëtareve qe 5(pesë) vite, me 1-2 shtatorit ka pas protesta në këto fshatra ,ku përveç kërkesave tjera ka qene edhe ajo e transportit publik ,ngaqë fëmijët e tyre po detyrohen ta ndërprerjen shkollimin për këtë shkake dhe se me mjetet e veta nuk kane mundësi te pagesës për çdo ditë udhëtimin në relacion fshatë -qytet .

**Selim Pacolli** nënkryetar i komunës tha se së shpejti do ta zgjidhim këtë kërkesë të arsyeshme dhe shumë të nevojshme duke filluar me linjën publike dhe në bazë të një platforme të re për transport edhe vendet më të largëta të malësisë së gollakut do ti plotësojmë me linja të reja private duke ju paguar pjesën e mbetur që nuk është kompensuar me mjetet e udhëtareve dhe se kjo kërkesë e banoreve do të zgjidhet brenda muajit tetor .

**Jonuz Salihaj** tha se me një forme te re vetëm gjere ne klasën e 5(pestë) shkollimi është obligimi, ndërsa nga shkolla e mesme e lartë nuk është obligim ligjor ,por duhet ta gjejmë një zgjidhje për ngritjen e cilësisë në shkolla, ku kemi paralele edhe me mbi 40 nxënës .

**Ilmi Uka** kam detyrë me iniciativën e dikujt tjetër jemi të përfaqësuar në organet komunale dhe në emër të 8(tetë) fshatrave të Gollakut siç janë Keqekolla ,Hajkobilla ,Prapashtica etj jam i thirrur dhe kam për obligim se Drejtoria Komunale e Arsimit nuk ka obligim, por Komuna duhet siguruar transporti për këto fshatra dhe se kjo ndal edhe shpërnguljen e të rinjve .



**Shkelzen Gjafa** komandant i policisë kishim një vide incizim te shkolla " Sami Frashri "këtu është çështja edhe për shpërndajnë e kamerave edhe në shkolla tjera ,ku ne i trajtojmë këto raste dhe merrem me ta .

**Pika e katërt** Organizimi i fushatave vetëdisuse për mes aktiviteteve rekreative, kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetarë, KLSP-të dhe bashkësitë fetare.

**Hetem Kupina** KLS- Bardhosh po filloj në bazë të detyrës ti përshëndes të gjithë me se tepërmi Drejtorin e Arsimit, i mora sugjerimet dhe këshillat gjithmonë duke u bazuar në rolin e KLSP identifikimi i shkurtër i elementeve të sigurisë dhe adresimi i tyre . Nuk e shtrova rastësisht pyetjen dhe se adresa e shqetësimeve tona është Ekzekutivi Komuna ,Policia dhe se ne jemi organ këshillues .Ka qenë e mirë që procesverbalit ti bashka ngjiten edhe përgjigjet që mungojnë nga drejtoria e arsimit gjithmonë duke u bazuar në kërkesa të arsyeshme si rojet e shkollës dhe instalimin e kamerave ku do të identifikohen personat që rrinë afër shkollës dhe e pengojnë procesin mësimor, mungon veprimi për parandalim me një investim të instalimit të kamerave duke u bazuar në rrezikun që mund të kemi nga përdorimi drogës në shkolla. Ne është dashtë të marrim nga ju ndonjë përpjekje për zgjidhje , jemi kundër parimit formal pyetje përgjigje .KLSP i ka mbledhjet çdo muaj i ftojme bashkësitë fetare dhe shoqërinë civile, zyrtaret i dëgjojnë opinionet të dhëna në KLSP-Policia e Kosovës .

**Hetem Kupina** -falënderojë për përkrahjen e OSCE në Bardhosh që na përkrahin për projekte të ndryshme

**Premtime Preniqi** Si zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Prishtinës, po ju jap si këshill që gjatë vendosjes së kamerave ta keni parasysh Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për arsye mandej mundemi me pasur vërejtje a ndonjë dënim për shkele të privatisisë nga Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Të ndryshme**

**Violeta Hasani** KLSP-Qendra - tha se problem paraqesin lokalet e natës që kanë muzike live 3 herë në javë pa leje te komunës dhe këtë problem e kam paraqitur edhe herëve tjera , pastaj tjetër problem paraqesin qenet endacak .Gjatë dhënies së lejeve të shfrytëzimit të hapësirës publike nga DSHPMSH a ka mundësi te ceket orari i punës se tyre . Gjatë takimit te fundit te KLSP -Stacioni qe është mbajtur ne stacionin Policor Qendra ka pas më shumë se 45 te pranishëm ku secili ka fjale te mira lidhur me zgjidhjen e problemeve , zëri jonë është ajo çfarë paraqet qytetari ne i respektojmë vullnetin e tyre .Te Sheshi "Edit Durham" pas 17 viteve me ndihmën tonë dhe organizimin e banoreve KLSP -Qendra kemi arrite me pru nxehjen nga "Term kosi "dhe banoret na janë shumë falënderues këtu është edhe bashkëpunimi i Komunës ku 29 familje janë pajisur me ngrohje është projekt i realizuar me vetëfinancimin e banoreve .

**Selim Pacolli** nuk kemi inspektor te mjaftueshëm që të kontrolloj një rrugë të caktuar ku kemi 6 inspektor komunal ndërsa kërkesat janë shumë më të mëdha.

**Jonuz Salihaj** për ta luftuar këtë dukuri negative te përdorimit te drogës ne shkollat tona duhet së bashku të bëjmë një plane për mënyrat e veprimit dhe te koordinohemi me të gjitha institucionet gjegjëse qe ndikojnë në këtë çështje organizmat Komunal, bashkësitë fetare policia OJQ-të. Përdoruesit e substancave narkotike me shume janë prezent në shkollat me standard më të lartë siç janë " Sami Frashri " pastaj "Ismajl Qemajli" e cila ka 2800, 75 institucione shkollore ku kemi trashëguar shumë probleme nga e kaluara dhe kemi bërë një plan dhe masat me prioritete për zgjidhjen e tyre. Ne jemi për respektimin e komuniteteve dhe jam ithtar për respektimin e Ligjit në institucionet arsimore, nuk ka arsye për jo



transparencë rekrutimi i mësimdhënësve të jetë i hapur nëse ka nevojë të behet në prani të mediave .

**Imer Thaqi** – Pas fjalimit te KLSP -Qendra ju dha fjala Imer Thaqi nga divizioni i sigurisë ne bashkësi MPB-ja i cili tha kur ndëgjojë këtë bashkëpunim dhe mirëkuptim mes KLSP-së Policisë ,Komunës tregohen sukseset e përbashkëta shihet qartë po punohet në të mirën e qytetareve dhe ju përgëzojë për punën që jeni duke bërë. Gjithashtu pyeti se a ka mundësi të na tregoni më shumë lidhur me ekipet për siguri në bashkësi.

**Fatmir Bilalli** tha se ekziston lista e EVSB-ve dhe se do ta bëjmë rifreskimin me anëtareve të ri dhe do te ju dërgojë listën e anëtarëve.

**Dejan Milladinoviç** përfaqësues i komunitetit serb pyeti se Boronicën e Poshtme para dy viteve është bërë ndriçimi dhe se tani 1/4 e këtyre poqave nuk funksionojnë dhe problem janë edhe qenet endacak.

**Hetem Kupina KLSP** tha se këtë e kam ngrit ne mbledhjet tona për siguri dhe se kjo çështje do të rregullohet me procedurat e tenderimit për pajisje me poqa elektrik.

**Hyra Ismajli KLSP-Dardani**-unë e zëvendësojë Safet Kamberi dhe jam pjesë e KLSP-së i cili herën e kaluar ka paraqite 5 pika te zeza për lagje dhe se dy nga ato janë zgjidhur te shkolla gropa është mbuluar ,pastaj rrjedhja e ujërave të zeza ku nxënësit kane kaluar dhe e kane pas vështirësi kalimi , presim që edhe në KLSP të jemi në nivel më të mirë.

**Hetem Kupina** ne fillim thashë se ne kemi identifikuar çështje që ndikojnë në siguri dhe njëra nga identifikim te problemit ka qenë edhe vërshimet gjatë të reshurave dhe kjo është pasojë e mospastrimit të lumenjëve .Problem tjetër qenet endacak .Transportimi i udhëtareve me taksi ilegal .Ndotja e ambientit nga ndezja e gomave dhe mbeturinat.

**Shkelzen Gjafa** ne si polici kemi masat për parandalim ne këtë aspekt me Drejtorinë e Arsimit bëjmë mbajtjen e ligjëratave dhe cd filmike ku përfshihen mosha 13-18 vjeçare që janë përdorues të drogës si dhe mesazhi për pasojat e kësaj dukurie, të japim kontributin tonë në këtë aspekt.

**Habib Qorri** shef i SHP tha se i shënove te gjitha ato që kane te bëjnë me SHP. Sa i përket ndriçimit se ¼ është pa poqa elektrik ajo se shpejti do të rregullohet dhe se si pasoje e frymës me madhe kane ndikuar ne dëmtimin e shumë trupave ndriçues , dhe përveç kësaj kemi plan për zgjerim të ndriçimit dhe kemi ne listë 300 kërkesa në pritje për zgjerim ndriçimi të cilat duhet trajtuar varësisht prioriteteve . Sa i përket problemit me ujërat e zeza dhe kanalizimit është kompetencë e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave. Ndërsa sa i përket problemit të vërshimeve dhe pastrimit të lumenjëve ,ne kemi pasur një tender për pastrimin e lumenjëve dhe është punuar në pastrimin e tyre por prape kanë hedhur mbeturina nga persona të papërgjegjshëm dhe se duhet një shumë me e madhe financiare për trajtim të kësaj çështje. Sa i përket problemit me qenet endacak Komuna e Prishtinës bënë trajtimin e tyre sipas ligjit dhe ata nga kompania e kontraktuar janë marre dhe sterilizuar dhe kastruar dhe ju vihen shenja përkatëse në bashkëpunim me Agjensionin e Veterinës dhe prapë janë kthyer në rrugë sepse nuk lejohen forma tjera apo eliminimi i tyre .

Sa i përket she njëzimit te rrugëve ne i kemi vendosur dhe nga këtu beje thirrje policisë , Inspektionit dhe qytetareve qe mos ti largojnë nga vendi i vendosur dhe te merren masa ligjore ndaj atyre që largojnë shenjat. Sa i përket transportit ilegal me këtë problem merret Inspektioni Komunal për largimin e tyre dhe marrjen e masave .

**Hetem Kupina** ai kërkojë qe ne këtë mbledhje të jetë prezent edhe Drejtori i Inspektionit dhe ne si KLSP ti paraqesim shqetësimet tona.

**Fatmir Bilalli Udheheqes i sektorit MSH** Pas pranimit të thirrjeve telefonike nga qytetarët në Qendër Komunale se komunën e Prishtinës me datën 24 shtator e ka përfshirë një stuhi e fortë, menjëherë kemi dalë me tri ekipe Emergjente të Drejtorisë së SHPMSH të Sektorit të Emergjencës, i kemi angazhuar kompanitë Komunale "Hortikultura" "Pastrimi" dhe "BP Zjarrfikësve" si dhe kompanitë e kontraktuara nga komuna "Dardania", "Toifor", "VZ copmany", "Vemor", "Elbao" dhe "Niti Company, me asistimin e Policisë në disa raste dhe angazhimin maksimila të kompanive kemi arritur të menaxhojmë situatën në të gjithë territorin e Komunës. Kemi pasur raste, zjarre fushore, Drunjë të rrëzuar, gjësende të rrëzuara nga objektet e larta, rrëzim të kulmeve, rrëzim të shtyllave të KEDS-it si dhe raste tjera. Rastet më të rënda që kemi intervenuar janë: Zjarre fushore Fushë Kosovë, Lebane, Uglar, Matiqan, rr. "Muharrem Fejza" rr. "Holgen Petersen në Arbëri afër varrezave, Veternik prapa Grand Stores dhe një shtëpi. Drunje të rrezuar në rrugët: Luan Haradinaj, Dardani në park, Shpetim Robaj afër shkollës normale, Berrnicë, te fakulteti teknik rr. Agim Ramadani dhe Fehmi Lladrovci Te Te banesat e bardha Bregu i Diellit, Bajram Bahtiri QKM Te Biblote Kombëtare afër kishës ortodokse. Te Bibloteka Kombëtare afër kishës ortodokse. Gjësendet që kanë rënë nga kulmi: në rr. Rexhep Luci, Dardani afër bibliotekës "Hivzi Sylejmani" ku ne bibliotekë është thyer dritarja dhe një person është lënduar, Ulpianë soliteri nr.1, Kulm i rrezuar në Kolovicën e re, një shtyllë e ndriçimit në rr. "Vëllezërit Fazliu" ku është njoftuar edhe KEDS.

#### Procesmbajtsja

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së KKSb-së

Shpend Ahmeti